

VENDIM
Nr. 471, datë 3.6.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 151, DATË 25.4.2002, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR STATUSIN “DËSHMOR I ATDHEUT””, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 112, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”, të ndryshuar, dhe të neneve 4, 13 e 20, të ligjit nr. 8607, datë 27.4.2000, “Statusi i Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 151, datë 25.4.2002, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Komisioni Qendror për dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut” kryesohet nga ministri i Mbrojtjes dhe përbëhet nga:

- Zëvendësministri i Mbrojtjes nënkryetar;

- Zëvendësministri i Punëve anëtar;

të Brendshme

- Zëvendësministri i Drejtësisë anëtar;

- Zëvendësministri i Mirëqenies anëtar;

Sociale dhe Rinisë

- Një përfaqësues i Shoqatës së anëtar;

Familjeve të Dëshmorëve të LANÇ-it

- Një përfaqësues i Organizatës së anëtar.”.

Veteranëve të LANÇ-ittë Popullit

Shqiptar

b) Në fund të paragrafit të parë, të shkronjës “c”, fjalët “...një herë në muaj...”, zëvendësohen me fjalët “...me kërkesën e kryetarit të Komisionit Qendror për dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut”...”.

2. Shkronja “c”, e pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Komisioni Qendror për dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut” shqyrton dokumentet e dërguara nga Këshilli i Qarkut ose Prefekti dhe relacionin e stafit teknik. Komisioni Qendror merr vendimin për shpalljen ose jo “Dëshmor i Atdheut” të të ndjerit dhe njofton të interesuarin nëpërmjet Këshillit të Qarkut ose Prefektit. Vendimi i Komisionit Qendror për mos dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut” duhet të jetë i arsyetuar.”.

3. Pas shkronjës “a”, në pikën 3, shtohen dy paragrafë, me këtë përmbajtje:

“Kërkesën për varrosjen ose rivarrosjen e Dëshmorit të Atdheut në kryeqytet e bën Këshilli i Qarkut ose Prefekti.

Varrimi i Dëshmorit të Atdheut në varrezat e Dëshmorëve të Atdheut në qarqe bëhet me vendim të Këshillit të Qarkut ose Prefektit.”.

4. Paragrafi i parë, i shkronjës “a”, në pikën 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Shpërblimi financiar mujor për familjen e Dëshmorit të Atdheut caktohet në masën 7 000 (shtatë mijë) lekë. Komisioni Qendror për dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut” i dërgon Institutit të Sigurimeve Shoqërore emrin e familjarit që përfiton shpërblimin financiar bashkë me një kopje origjinale

të vendimit për dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut”. Një kopje e vendimit të komisionit, në çdo rast, vendoset në dosjen përkatëse të “Dëshmorit të Atdheut”.

5. Pas pikës 6 shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

“7. Trajtimi financiar për rrethin familjar të Dëshmorit të Atdheut fillon në datën e shpalljes së vendimit të Komisionit Qendror për dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut”.

Trajtimi financiar për rrethin familjar të Dëshmorit të Atdheut, i cili e ka fituar të drejtën për t’u njohur si Dëshmor i Atdheut me vendim gjykate të formës së prerë, fillon nga data e vendimit të komisionit për mosdhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut”.

6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare. Efektet financiare fillojnë nga data 1.1.2016.

KRYEMINISTRI

Edi Rama